



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 1209 prot

Tiranë, më 28/09/2021

URDHËR

Nr. 144 Datë 28/09/2021

MBI

**MARRJEN E MASAVE PËR FILLIMIN E VITI TË RI AKADEMIK NË KUSHTET
E PANDEMISË SHKAKTUAR NGA SARS-COVID 19**

Drejtuar: Prof.Dr. Isak Shehu Dekan i FM

Prof. Petrit Malaj Dekan i FAS

Prof. Artan Peqini Dekan i FAB

Në mbështetje të urdhrit Nr. 413, datë 24.09.2021 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit Covid-19 për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët"

URDHËROJ

1. Me fillimin e procesit mësimor, të gjithë anëtarët e stafit akademik, ndihmës akademik dhe personelit administrativ duhet të depozitojnë pranë sekretarive mësimore sipas fakulteteve përkatëse, certifikatën e vaksinimit të Covid 19 nga e-albania apo kartën e vaksinimit.
2. Për anëtarët e stafit akademik, ndihmës akademik dhe personelin administrativ që nuk paraqesin certifikatën e vaksinimit Covid -19 apo kartën e vaksinimit, do të kërkohet paraqitja çdo jave e testit PCR të kryer sipas procedurave për kryerjen e testeve për efekte administrative, për të verifikuar që nuk janë mbartës të infeksionit të Sars-Covid 19
3. Përjashtim nga rregullat e përcaktuara më sipër, bëhet vetëm në rastet që kanë indikacion mjekësor të përcaktuar me dokument mjekësor për mosaplikimin e vaksinës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

4. Fakultetet të marrin masa për njoftimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe personelit administrativ me këtë urdhër

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

Prof. Kastriot CAUSHI



REKTOR